K.B.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr 21670 *prot.* *Lezhë, më:* 05.11 *.2026*

PROJEKT-V E N D I M

NR. ___, Datë 05-11- **, 2026**

PËR
DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR TË SIPËRFAQES PYJORE/KULLOSORE NË PRONËSI TË BASHKISË DHE SIPËRFAQES PYJORE NË PRONËSI PRIVATE, PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT MINERAR TË SHFRYTËZIMIT TË GURIT GËLQEROR, NË OBJEKTIN BALLDRE, NGA SHOQËRIA "LEZHA KONSTRUKSION" SH.P.K.

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, proçedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", udhëzimin Nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit Mjedisit, "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar" pas shqyrtimit të dokumentacionit, Kryetari i Bashkisë:

PROPOZON:

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor kombëtar sipërfaqen prej **4.64 ha** kullotë në pronësi të Bashkisë dhe në pronësi private, sipas raportit tekniko ekonomik bashkangjitur.
2. Sipërfaqja që do të hiqet nga fondi pyjor/kullosor kombëtar detajohet si mëposhtë:

- **2.92** ha kullotë në ngastrën pyjore **31**, ekonomia pyjore "Mali i Kakarriqit".
- **1.37** ha kullotë në ngastrën pyjore **31b** ekonomia pyjore "Mali i Kakarriqit", pronë private, me numër pasurie **682/2 ZK 1783**.
- **0.35** ha kullotë në ngastrën pyjore **15e**, ekonomia pyjore "Mali i Kakarriqit".

3. Rehabilitimi i sipërfaqes pyjore/kullosore të dëmtuar jashtë pjesës ku kryhet aktiviteti, bëhet nga shoqëria **"LEZHA KONSTRUKSION" sh.p.k**, sipas marrëveshjes së dakortësuar me Bashkinë, pasi të miratohet heqja nga fondi pyjor.
4. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

KRYETARI

Pjerin NDREU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË